



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prilbjen/Prodato Received/Delivered	05.05.2022	viti god year	
Organ /Njësia Organ /Jedinstvo Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMBHLK	2610/2022		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A . Nr. 275/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani, Kryetar Malsore Gashi - Bajraktari dhe Jeton Koca anëtarë, me Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës A. Nr. 275/2022, të datës 23.03.2022, së ankueses me adresë banimi rruga

nga Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "*kompensim material*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim me datë 04.05.2022, mori këtë;

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar, ankesa me numër A.Nr.275/2022 e datës 23.03.2022, e parashtruar nga ankuesja

II. MBETET në fuqi, shkresa e datës 09.03.2022, e numër protokolli 347, e datës 09.03.03.2022, e Zëvendësuese së Sekretares së Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar sipas shkresave të lëndës në Ministrinë e Punëve të Brendshme, më datë 23.03.2022, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore, lidhur me pezullimin e shtesave mbi pagën bazë për kushte specifike të punës.



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 31.03.2022, ka bërë kërkesë për përgjigjen në ankesë tek Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa më datë 08.04.2022, Ministria e Punëve të Brendshme, ka dërguar përgjigje me shkresat e bashkëngjitura.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën e datës 23.03.2022, e parashtruar nga ankuesja me numër protokoll 1545/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 26.01.2017, i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme; Akt emërimit të datës 31.01.2013; Përshkrimi i detyrave të punës; Vendimi i datës 23.07.2021, i zëvendësueses së Sekretares së Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme; Refuzimi i kërkesës i datës 09.03.2022; lista e pagave; Raporti i Auditimit i datës 07.09.2021; Përgjigje në ankesë e datës 08.04.2022, me numër protokoll 1969/2022, me shkresat e bashkëngjitura.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkëngjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses *është e pa bazuar sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses e cila pretendon se organi i punësimit Ministria e Punëve të Brendshme, shtesat mbi pagën bazë për kushte specifike, i ka ndaluar në mënyrë të kundërligjshme, prandaj kolegji pasi që ka analizuar dhe shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses dhe gjitha provat dhe faktet relevante të parashtruar nga ankuesja dhe organi i punësimit, ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankueses janë të pa bazuara.

Ndërlidhur me pretendimin ankimor të ankueses për shtesën në pagë për shkak të kushteve specifike në punë, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se ky pretendim i ankueses është i pa bazuar sepse ankuesja shtesën në pagë për shkak të kushteve specifike e ka realizuar në bazë të vendimit me Nr.085 të datës 26.01.2017 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ndërsa Zëvendësuesja e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë me vendimin me numër protokoll 667/2021 të datës 23.07.2021 ka pezulluar të gjitha vendimet të Sekretarit të Përgjithshëm për aprovimin e shtesës mbi pagën bazë për kushte specifike të punës për stafin civil të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Arsyeja për pezullimin e këtyre vendimeve nga Zëvendësuesja e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme ka qenë Raporti i Auditimit të brendshëm i datës 08.07.2021 me kërkesë të Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore. Andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se vendimi me numër protokoll 667/2021 i datës 23.07.2021 e Zëvendësueses së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme është i drejtë, po ashtu me datë 09.03.2022, për mes shkresës me numër protokoll 347, Zëvendësuesja e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme ka refuzuar kërkesën për shtesa mbi pagën bazë për kushte specifike të punës- Divizionit për Shërbime private të Sigurisë /DSP-MPB .



Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vlerëson se realizimi i shtesës për kushte specifike të punës për ankuesen mund të bëhet vetëm pas aprovimit nga institucionet përgjegjëse respektivisht Ministria Përgjegjëse për Administratë Publike, siç parashihet me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 16 paragrafi 1, dhe 2 ku përcaktohet se: 1. Në institucionet e administratës publike, në të cilat ekziston nevoja që disa nëpunës civilë të punojnë në kushte specifike pune, ku si pjesë e detyrave të tyre të rregullta ata iu ekspozohen kushteve dhe kërkesave të veçanta në vendin e punës dhe që paraqesin rrezik për shëndetin, institucioni kërkon miratimin e një shtese për kushte të punës për këta nëpunës civilë, sipas aktit nënligjor të përcaktuar në paragrafin 2. të këtij neni. 2. Kriteret për përkufizimin e kushteve specifike të punës, shuma e shtesës si dhe procedurat për paraqitjen e kërkesës për shtesën për kushte specifike pune, përcaktohen me akt nënligjor, të nxjerrë nga Qeveria, pas propozimit të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financat, si dhe dispozitat e Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë, përkatësisht nenit 7 paragrafi 3 ku përcaktohet se ... për aprovimin e shtesës për kushte të veçanta, institucioni duhet t'i ofrojë Ministrisë përgjegjëse për Administratë Publike kërkesën që përmban: 3.1 arsyeshmërinë për pagimin e shtesës për kushte specifike të punës për pozitën (at) përkatëse; 3.2 listën e pozitave përkatëse, gradat dhe numrin e nëpunësve civilë për çdo pozitë; 3.3 detajet, sipas të cilave, secila pozitë përkatëse pritet të jetë e ekspozuar ndaj rrezikut; 3.4 koston vjetore të vlerësimit financiar të shtesave për kushte specifike të punës.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.275/2022

Rushit KAJTAZI

Proesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Sekretarit/es të Përgjithshëm/e të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

